




|   |             |
|---|-------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO |             |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT                            |             |
| AGJENCIA PROTIV KORUPCIJE                               |             |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY                                  |             |
| Dep.  | DPK         |
| Dep.  | 03-02/60/18 |
| Dep.  | 02          |
| Nr. i faq   | 11-01-2018  |
| Broj stranica   |             |
| Nr. pages   |             |
| PRISHTINE   |             |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.01.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-02-2457/17, për zyrtarin e lartë z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2457/17, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.**

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z.Uran Ismaili, figuron si person i autorizuar në bizneset private me emër "Bon Vivant" SH.P.K, si dhe " Tranquille" Sh.p.k. e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkresë z.Ismaili, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interes për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për rastin që është duke u trajtuar.



Lidhur me ketë çështje është organizuar një takim me zyrtarin e lartë z.Uran Ismaili, në ketë takim zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me rastin e iniciuar.

z.Ismaili, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar, por ka deklaruar se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar në këto biznese.

Pas këtyre veprimeve, nga z.Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë, kemi pranuar dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë Uran Ismaili, nuk figuron me si person i autorizuar ne bizneset private me emër “Bon Vivant” SH.P.K, si dhe “Tranquille”Sh.p.k

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke bërë ndryshimet në bizneset private, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në bizneset private janë krijuar rrëthana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

